

## SHKODRA, NJË DËSHMI E KONVERGIMIT KULTUROR NË PANORAMËN E MES SHEKULLIT XIX<sup>1</sup>

Shkodra, në shekujt XVIII dhe XIX, ishte një qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore. Tregu shkodran zhvillonte një veprimtari të gjerë që kulmoi me një zhvillim të madh ekonomik nga mesi i shekullit XIX. Në shekullin XVIII, sanxhaku i Shkodrës kishte një rëndësi të veçantë, si për Perandorinë Osmane, ashtu dhe për shtetet e krishtera përreth Adriatikut, veçanërisht për Venedikun, pasi Shkodra si kryeqendër, ishte e lidhur nëpërmjet tregtisë me botën perëndimore dhe me brendinë e Turqisë Europiane, ku të dyja palët, si osmanët, ashtu dhe venedikasit kishin interesa të përbashkëta, të mbështetura në lidhjet e vjetra ekonomike, afërsinë e skelave, si dhe interesat politike.<sup>2</sup> Tregtarët kishin agjencitë e tyre në vende të huaja, të cilat kryenin tregtinë me qytetet italiane e deri me Austrinë, Stambollin etj., siç ishin firmat tregtare “Vëllezërit Suma”, firma “Çoba”, e më tej në fillim shekullit XX, firmat “Pema” e “Zahara”, të cilët vazhdojnë traditën e përcjellë ndër vite. Letërkëmbimet tregtare me qendra të rëndësishme si Ragusa, Venediku, Trieste, Korfuzi etj.,<sup>3</sup> dëshmojnë për lidhjet e ngushta të Shkodrës me qytetet e tjera bregdetare të Adriatikut, si dhe me ishujt jonianë. Dëshmitë e disa ndalesave për zhvillimin e tregtisë apo lëvizjes së tregtarëve nga Shqipëria drejt Italisë në vitet 1699, 1707 dhe 1729,<sup>4</sup> të shpallura nga guvernatorët e Piacencës, për arsye të rrezikut të përhapjes së sëmundjeve, tregojnë për marrëdhëniet e ngushta me qytetet italiane. Në këto vite çdo lloj tregtie ose praktikë shkëmbimi u

1 Ky artikull është botuar për herë të parë në “Gazetën Shqiptare”, më datë 20 gusht 2017. Materialet arkivore të përcjella në këtë artikull janë pjesë e fondit të Arqipeshkëvisë së Shkodrës, pranë Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH) në Tiranë. Ato vijnë për herë të parë për lexuesin.

2 Materialet arkivore të përkthyer e të redaktuara nga Stavri Naci janë pjesë e fondit V. Sasi alla Mercanzia-Consoli di Scutari, të cilat gjenden në Arkivin Shtetëror të Venecias. Shih: Stavri N Naci, (përkth. red.), “*Shqipëria e Veriut në Shek. XVIII: (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës), vëllimi I (1706-1756)*”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1967, f. 9-11.

3 Zija Shkodra, *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984, f. 236.

4 ASHQ, Fondi 132, D. 1, fl. 1r, 26 mars 1699; ASHQ, Fondi 132, D. 1, fl. 1r, 5 shkurt 1707; ASHQ, Fondi 132, D. 1, fl. 1r, 1 qershor 1729.

ndalua, por jo vetëm për Shkodrën, por dhe për qytete të tjera si Korfuzi, Qefalonia e Raguza. E pikërisht në këto qendra, tregtarët shkodranë që në shekullin XVIII kishin krijuar agjencitë dhe shtëpitë e tyre tregtare.<sup>5</sup> Hapja e agjencive konsullore të disa vendeve të huaja, duke filluar nga shekulli XVIII, dëshmon për klimën e favorshme institucionale, shoqërore e kulturore të këtij qyteti. Ndërsa në anën tjetër lidhjet me Romën nga ku rrezatonte politika e Propaganda Fides, ndihmonte në përforcimin e depërtimin e frymës katolike. Pra, në tërësi, Shkodra shfaqet si një qytet me karakteristika të zonave të tokave të kufirit, një qytet me disa referenca kulturore.

Termi “*tokë kufiri*” (*borderland*), një koncept antropologjik, i përdorur nga studiuesit për të shpjeguar natyrën kozmopolite dhe hibride të qyteteve-porte osmane, ndihmon për të kuptuar mjedisin kulturor, shoqëror e institucional të Shkodrës së shekullit XIX. Këto qytete “kufiri”, ndryshe nga tokat e zonat e brendshme, funksiononin si zona ndërmjetëse, si “toka të mesit” midis osmanëve dhe europianëve,<sup>6</sup> dhe kishin më shumë ngjashmëri me ato europiane e të Mesdheut, sesa me brendësinë e tokës dhe zonat më të thella (*hinterlandin*). Të këtij mendimi janë dhe studiues të tjerë, të cilët shprehen se Shqipëria, në shekujt e parë të erës moderne, nuk ishte as osmane, as veneciane, por më së shumti me një ngjashmëri si Qefalonia e Zante, sipas përshkrimit të gjeografit francez, Nikolas de Nikolai (Nicolas de Nicolay).<sup>7</sup> Njerëzit në kufi kishin krijuar identitete me shumë shtresa dhe jo të kuptueshme.<sup>8</sup> Këto zona ishin kulturalisht heterogjene.

Marrëdhëniet tregtare e të afërta të Shkodrës me Venedikun, ndikimi e rrezatimi i autoritetit të Propaganda Fides së Romës, sistemi administrativ osman, konsullatat e huaja në vend, mjaftojnë për të kuptuar se ky qytet ishte një pikë nevralgjike e përballjeve kulturore e politike. Si e tillë Shkodra ndihmoi e artikuloi dinamikat e lëvizjes së grupeve apo individëve në mesin e shekullit XIX. Situata e saj shoqërore e politike strukturoi zhvendosjen

5 Shkodra, *Qyteti Shqiptar*, f. 261.

6 *Mbi konceptin e kufirit të qyteteve-porte osmane*, shih artikullin: Onur Inal, “Women’s Fashions in Transition: Ottoman Borderlands and the Anglo-Ottoman Exchange of Costumes”, në (Ed.) Constanta Vintilă-GhiŃulescu, “*From Traditional Attire to Modern Dress: Modes of Identification, Modes of Recognition in the Balkans (XVIth – XXth Centuries)*”, Cambridge Scholars Publishing, 2011, f. 148.

7 Nicolay, Nicolas de., *Les quatre premiers limes des navigation et peregrinations orientates de N. de Nicolay, Lyon: 1567*, vepër e cituar në: Palmira Brummett, “*Mapping the Ottomans. Sovereignty, Territory, and Identity in the Early Modern Mediterranean*”, Cambridge University Press, UK, 2015, f. 258.

8 Brummett, *Mapping the Ottomans*, f. 258.

e atyre individëve, të cilët jetonin ose përballeshin me jetën e të qenit në kufi, siç ishte në rastin e ishullit të Korfuzit.

Falë pozitës së saj gjeografike, por dhe njëkohësisht të kushteve dhe të rrethanave që ofronte ky qytet, Shkodra mund të ishte e depërtueshme dhe e favorshme nëse krijoheshin hapësira të njëjta veprimi për ata individë të cilët kërkonin të vendoseshin këtu. Pavarësisht kësaj, kufijtë midis qytetërimeve nuk ishin hapësira mbi të cilat mund të aplikoheshin rregullat e vendit tjetër apo të krijohej i njëjti mjedis në vendin tjetër, kjo sepse nevojitej një mbështetje dhe paraqitej domosdoshmëria e një familjariteti me vendin ku dikush vendosej.<sup>9</sup> Kjo fillonte së pari me familjet e rëndësishme tregtare shkodrane që kryenin tregti me Venedikun, Piacencën, Austrinë, Stambollin etj., të cilët ishin përçues të kulturave dhe ideve. Kjo gjë favorizonte e mundësonte strategji për krijimin e terreneve e zonave hibride, si dhe familjaritet me qytetet përtej, ata ishin njerëz kozmopolitë dhe më të familjarizuar me kulturën përtej Adriatikut. Në panoramën e meshekullit XIX Shkodra ishte një dëshmi e konvergimit kulturor.

Ardhja e piktor Pietro Marubit (Piacenca, 1834-Shkodër,1903) fillimisht në Korfuz e më pas në Shkodër në mesin e shekullit XIX, tregon se ndoshta lidhje të veçanta, përveç atyre tregtare, të kenë qenë midis Piacencës e Shkodrës, Korfuzit e Shkodrës, por dhe një rrjet komunikimi i vendosur kohë më parë. Në këtë aspekt, Shkodra e shekullit XIX ofronte mundësi depërtimi dhe krijimin e një terreni të ngjashëm, me kushte të favorshme me vendin e origjinës së personit që kërkonte të vendosej aty. Në Shkodër gjendeshin konsullatat e huaja si ajo angleze; gjendeshin persona të cilët kishin emigruar aty e kishin krijuar grupime të vogla në qytet, dhe kështu, ishte krijuar një mjedis që përcillte frymën kulturore të Adriatikut.

Fakti që në Shkodër gjendej një komunitet katolik, si dhe vendosja e konsullatave të huaja veçanërisht vendosja e konsullatës angleze, e favorizoi lëvizjen dhe vendosjen e disa qytetarëve nga Korfuzi drejt Shkodrës, ku shumë prej tyre, si Marubi e Idromeno ishin vendosur. Këshilla e konsullit italian në Vlorë për Marubin, për të shkuar në Shkodër *“se atje ka katolikë”*, tregon se aty ai mund të gjente veten brenda një mjedisi të ngjashëm kulturor me vendin që kishte lënë pas. Qenësia për një ngjashmëri semantike midis vendeve, të atij që lë pas e atij kudo të vendoseshë, ishte e domosdoshme.

Piktori Marubi, që më pas u bë fotograf, themeloi dinastinë e fotografëve që i dhanë Shkodrës një dimension të ri kulturor. Nga ana tjetër

9 Stephen Ortega, *Negotiating transcultural relations in the early modern Mediterranean: Ottoman-Venetian encounters*, Farnham, Surrey, UK; Burlington, VT: Ashgate, 2014, f. 94.

në Shkodër ai mund të gëzonte të drejta më të plota si qytetar. Kështu, siç tregojnë burimet arkivore, këta individë ishin mbështetje dhe garanci për të tjerët që vinin të qëndronin në Shkodër, si dëshmitarë apo si persona që ofronin garanci. Mjedisi institucional-administrativ si dhe ai kulturor i jepte formë dinamikave të lëvizjes së individëve, duke krijuar një mjedis të ngjashëm me vendin e origjinës të tyre. Duke qenë se ishujt jonianë, ku bënte pjesë dhe Korfuzi, ishin protektorat britanik deri më 1864-n, ata që shpërnguleshin nga ishulli e mund të shkonin në Shkodër, gjenin mbështetjen e britanikëve, sepse atje gjendej edhe konsullata angleze.

Një nga rastet e veçanta, pavarësisht vështirësive të ndryshme, është rasti i Pashko Vasës (ndonjëherë i cituar dhe me emrin Pasquale) dhe gruas së tij të dytë Katarina Bonatti, e cila ishte nga Preveza. Pashko Vasa kishte marrë një vërtetim nga peshkopi i Shkodrës, ndërsa Katarina kishte tentuar të merrte një dëshmi pranë konsullatës angleze në Prevezë për statusin e saj të lirë civil, të cilin nuk e kishte marrë. Mungesa e një zyrtari katolik (*ministro*), nuk e kishte mundësuar këtë.<sup>10</sup> Në këtë mënyrë, për të lehtësuar e mbështetur lëvizjen dhe jetën e individëve, nevojiteshin dy gjëra: mbështetja nga konsullata britanike dhe aprovimi nga autoriteti kishtar katolik. Shkodra i plotësonte të dyja këto kritere. Për këtë arsye, të ardhur, të larguar, të arratisur zgjodhën të vendoseshin në Shkodër.

Një nga këta, ishte babai i Kolë Idromenos, Arsenio Idromeno. Me origjinë nga Parga, por i lindur në ishullin e Korfuzit, Arsenio Idromeno u martua me Roza Saraçin, nga një familje qytetare katolike shkodrane. Me profesion ishte marangoz dhe me vullnetin e tij të lirë, më datë 3 dhjetor 1858, Arsenio Idromeno i dërgon kërkesë konsullatës angleze në Shkodër, ku kërkon kthimin e tij nga besimi ortodoks kristian në atë katolik roman. Konsullata angleze i drejtohet famullitarit Radoja për konvertimin e Arsenios. Në këtë kërkesë firmosin dhe dy dëshmitarë, Pietro Marubi dhe Spiridon Rossi.<sup>11</sup> Si Marubi, ashtu dhe S. Rossi nuk ishin vendës. Për Marubin mendohet se ka mbërritur në Shkodër rreth vitit 1856. Fillimisht ishte larguar për në Turqi, më pas në Korfuz, Vlorë, e së fundmi në Shkodër. Dy vjet më vonë, Pjetër Marubi realizon fotografinë e parë në studion e tij. Spiridon Rossi, me profesion murator, ashtu si dhe të tjerë, kishte ardhur nga Korfuzi. Ai ishte djalë i Johanit nga Korfuzi dhe po aty ishte martuar me një vajzë nga Zante (Greqi).<sup>12</sup>

Po në këtë datë, zëvendës konsulli britanik në Shkodër, Spiridon

10 AQSH, Fondi 132, D 11, fl. 2, data 23 maj 1861.

11 AQSH, Fondi 132, D 9, fl. 2-7, data 3 dhjetor 1858.

12 AQSH, Fondi 132, D 13, fl. 26, data 27 nëntor 1842.

Bonatti, paraqitet së bashku me Arsenio Idromenon pranë zyrës së famullitarit Radoja, ku paraqesin kërkesën e tij për t'u konvertuar në besimin katolik. Ai, më datë 6 dhjetor të vitit 1858, në prezencë të Pietro Marubit dhe Nikollë Sahatçiu, konvertohet në fenë katolike. Gjithashtu, brenda së njëjtës datë, Arsenio Idromeno martohet me Rozën, vajzën e Filip Saraçit, në prezencë të Anastas Papanikut (Anastasio Papanico) dhe Agostin Rakacolit (Agostin Racazzoli).<sup>13</sup> Këta dy të fundit janë dëshmitarë të besimit katolik. Anastas Papaniku ishte shtetas osman, i cili kishte punuar në konsullatë dhe në bazë të shërbimit të tij gëzonte mbrojtjen nga konsullata angleze. Ai ishte një person mbështetës, garant e dëshmitar për të. Lista e personave të cilët gëzonin mbrojtje nga konsullatat në Shkodër, në atë kohë është nxjerrë nga Pashko Vasa nga arkivi qeveritar në Shkodër. Dokumenti mban datën 29 korrik 1860.<sup>14</sup> Ndërsa disa vite më vonë, rreth 1867-ës, emri i Agostin Rakacolit figuron në rolin e muftarit, dhe vite më vonë, Kolë Idromeno do të projektonte banesën e familjes Rakacoli. Dy vjet pas martesës së Arsenit me Rozën, në vitin 1860, do të lindte Kolë Idromeno, piktor e fotograf, i cili ndoqi rrugën e Marubit. Në fund të gjithë procedurës së konvertimit, zëvendës konsulli britanik Bonatti i drejton një letër peshkopit të Shkodrës Luixhi Çurçia, duke e falënderuar për aprovimin e procedurës.

Rasti i kërkesës së martesës së një vajze me emrin Kiara (Chiara alias Fotini) nga Korfuzi, konvertimi nga besimi ortodoks në atë katolik,<sup>15</sup> na ndihmon për të kuptuar më nga afër ndoshta ardhjen e Arsenio Idromenos në Shkodër. Gjithashtu, disa raste të tjera të ngjashme dëshmojnë për një komunitet të pranishëm të ardhur nga Korfuzi e të vendosur në Shkodër, të cilët në pjesën më të madhe kërkojnë t'i bashkëngjiten komunitetit katolik të qytetit.

Kiara, vajza e Aleksandër Fokës me origjinë nga Korfuzi, kërkon të martohet me Mateo Bissi nga Forli (Itali), që banon në Shkodër prej shumë vitesh. Në Shkodër, më datë 4 korrik të vitit 1860, dëshmitarët Arsenio Idromeno, Federiko Xhangaroli (Federico Giangaroli) dhe Xhuzepe di Mari (Giuseppe Di Mari), si dhe në prezencën e famullitarit Ëngjëll Radoja, dëshmojnë se gjatë periudhës që ata kanë qenë në atdheun e tyre (ata nuk kishin qenë atje që prej dy vitesh), se Fotini nuk ishte larguar asnjëherë nga Korfuzi dhe nuk kishte qenë e martuar atje. Po kështu, Arsenio Idromeno, së bashku me Federiko Xhangarolin dhe Spiridione Rossin, dëshmojnë

13 AQSH, Fondi 132, D 9, fl. 7r, data 6 dhjetor 1858.

14 AQSH, Fondi 132, D 13, fle. 213, data 29 korrik 1860.

15 AQSH, Fondi 132, D 13, fl.64, 4 korrik 1860.

për statusin e lirë civil të një personi të quajtur Cirillo Bertoni, të cilin e njihnin prej disa vitesh.<sup>16</sup>

Këto raste të nxjerra nga dokumentet arkivore na ndihmojnë për të kuptuar se lëvizja e komuniteteve të ndryshme, si dhe interesat politike shpesh diktonin e ndryshonin gjeografinë sociale. Nga ana tjetër, një rol organizativ të komuniteteve luanin dhe referencat dhe mbështetja e rrjetit komunitar të krijuar në qytete si Shkodra. Koncepti i tokave të kufirit ndihmon për të kuptuar pozitën e njerëzve, grupimeve shoqërore tranzite e në lëvizje, se si individët e vendeve të ndryshme vepronin me njëri-tjetrin,<sup>17</sup> por dhe se si krijonin rrjete bashkëpunimi.

---

16 AQSH, Fondi 132, D 13, fl.24, data 4 korrik 1860.

17 Ortega, *Negotiating transcultural*, 5.